



Data: 05.02.2019

Ref.: 190/130

Në mbështetje të Nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

V E N D I M

1. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të Universitetit "Fehmi Agani" në Gjakovë si më poshtë:
 - Edukim Fillor, BA, 240 ECTS;
 - Edukim Parashkollor, BA, 240 ECTS;
 - Infermieri, BSc, 180 ECTS;
 - Mami, BSc, 180 , ECTS
2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*.

Sipas Nenit 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, *"IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo më larg se data 31 tetor"*, për IAL janë të obliguara që të deklarojnë stafin akademik më së largu deri më 31 tetor 2018. Sipas pikën 3 të Nenit 30 të UA për Akreditim, *"Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do të konsiderohet në procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit"*.

Pas deklarimit të stafit akademik të IAL-ve, AKA ka filluar me verifikimin e dokumentacionit të tyre me qëllim të konfirmimit të plotësisë të kriterëve ligjore për secilin program të studimit. Në mbledhjen e mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, KShC analizoi në detaje të gjithë dokumentacionin e secilit staf akademik të propozuar si bartës të programeve nga IAL-të. Pasi analizoi fushat e studimit për secilin prej tyre, mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

1. Për programin e studimit: *Edukim Fillor, BA, 240 ECTS*, bartës të këtij programi Universiteti "Fehmi Agani" në Gjakovë (tash e tutje Universiteti) ka paraparë këtë staf: Behxhet Gaxhiqi, Ilir Kelmendi, Lulzim Zeneli dhe Shaban Buza.

Ky program ka 240 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Universiteti duhet të ketë të paktën katër staf akademik me gradën shkencore PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit. Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Universiteti, për këtë program të studimit, u konstatua që asnjëri nga bartësit e këtij programi nuk është i fushës së edukimit, dhe mbi këtë bazë KShC mori vendim si në dispozitiv.

Sipas dokumentacionit të kualifikimit të stafit akademik, Behxhet Gaxhiqi është PhD në Punë Sociale (Shkenca të Sociologjisë), Ilir Kelmendi, PhD në Shkencat e Historisë, Lulzim Zeneli, PhD në Shkencat e Kimisë, dhe Shaban Buza, PhD në Shkencat Teknike. Nga sa u tha më lartë asnjëri nga katër bartësit nuk i përket fushës së programit të studimit.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, të tërheq akreditimin për programin e studimit *Edukim Fillor, BA, 240 ECTS*.

2. Për programin e studimit: *Edukim Parashkollor, BA, 240 ECTS*, bartës të këtij programi Universiteti ka paraparë këtë staf: Sindorela Doli-Kryeziu, Ruzhdi Kadrija, Ilmi Hoxha dhe Mimoza Dushi.

Ky program ka 240 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Universiteti duhet të ketë të paktën katër staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit. Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Universiteti, për këtë program të studimit, u konstatua që ky institucion nuk ka staf akademik të mjaftueshëm për këtë program sipas fushës së studimit, siç parashihet me Nenin 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim. Bazuar në dokumentacionin e verifikuar, u vërtetua se: Sindorela Doli-Kryeziu është PhD në Gjuhësi, Ruzhdi Kadrija, është PhD në Shkenca Sociale, profili Psikologji-Pedagogji, Mimoza Dushi, është PhD në Gjeografi. Ndërsa Ilmi Hoxha, është PhD nga Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Matematikë dhe Inxhinierisë Fizike.

Bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, të tërheq akreditimin për programin e studimit *Edukim Parashkollor, BA, 240 ECTS*.

3. Për programin e studimit: *Infermieri, BSc, 180 ECTS*, bartës në këtë program janë: Faton Hoxha (PhD në Shkencat e Mjekësisë), Haxhi Kamberi (PhD në Shkencat e Mjekësisë) dhe Ramush Bejiqi (PhD në Shkencat e Mjekësisë- Pediatri).

Sipas paragrafit të fundit të Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *"për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*.

Pas analizës së stafit të prezantuar nga Universiteti i Gjakovës u konstatua se asnjëri nga bartësit e lartëcekur nuk mbulon fushën e programit të studimit në Infermieri. Për më tepër, në këtë program janë shkelë kushtet e akreditimit të dhënë me vendimin paraprak.

Bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të tërheq akreditimin për programin e studimit *Infermieri, BSc, 180 ECTS*.

4. Për programin e studimit: *Mami, BSc, 180, ECTS*, bartës kanë paraparë këtë staf: Ilirjane Raça Bunjaku, Antigona Dervishaj Ukëhaxhaj, Selami Sylejmani (PhD in Medicine Sciences) (09.01.1954) (Ka vendim për zgjatje të kontratës së punës deri më: 30.09.2019 si dhe kontratë pune). Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Universiteti duhet të ketë të paktën tre staf akademik me gradën shkencore PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit. Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Universiteti, për këtë program të studimit, u konstatua që asnjëri nga bartësit e këtij programi nuk është i fushës së *Mamisë*, dhe mbi këtë bazë KShC mori vendim si në dispozitiv.


Sipas dokumentacionit të kualifikimit të stafit akademik, Ilirjane Raça Bunjaku është PhD në Lëndët Klinike, Antigona Dervishaj Ukëhaxhaj, PhD në Shëndetin Publik dhe Selami Sylejmani PhD në Shkenca të Mjekësisë, i cili poashtu ka arritë moshën e pensionimit. Sipas Nenit 67 të Ligjit të Punës, arritja e moshës 65 vjeçare është kusht ligjor për ndërprerje të kontratës së përfunduar. Sipas paragrafit 1.4 të këtij Neni, kontrata ndërpritet "kur i punësuari e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç". Bazuar në këtë, i njëjti nuk mund të jetë bartës i këtij programi.

Bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit akademik të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të tërheq akreditimin për programin e studimit *Mami, BSc, 180, ECTS*.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditësh dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani";
- MASHT-it; dhe
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë